

Norma Efektive e Interesit

Shembuj te llogaritjes se normes efektive te interesit (NEI)

Kredia Ekspres

Monedha	Shuma	Periudha	Norma e Interesit	NEI
ALL	500,000	5 vjet	8.50%	9.37%

Kredia per Shtepi

Monedha	Shuma	Periudha	Norma e Interesit	NEI
ALL	4,000,000	30 vjet	4.5%	5.3%
EUR	40,000	30 vjet	4.5%	5.25%
USD	40,000	30 vjet	7.5%	8.18%

**Eshte marre ne konsiderate norma minimale e interesit pas vitit te pare te kredise.*

Ne perlllogaritjen e NEI perfshihen edhe kostot e sigurimit te jetes dhe te prones (ne rastet kur aplikohet) si dhe komisioni I administrimit sipas kushteve te punes ne fuqi. NEI ndryshon ne varesi te ndryshimit te kohezgjatjes se kredise dhe kostove te aplikuara.

Metoda e llogaritjes se normes efektive te interesit per kredine

Ekuacioni baze per llogaritjen e normes efektive te interesit (NEI), barazon ne nje baze vjetore, nga njera ane vleren totale faktike te kredise, duke zbritur cdo shpenzim te mbajtur (per shembull, shpenzimet administrative etj.) te vene ne dispozicion te klientit sipas marreveshjes se kredise dhe ne anen tjeter vleren totale faktike te shlyerjeve dhe/ose te pagesave te shpenzimeve:

$$\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

Kuptimi I shkronjave dhe simboleve:

m – eshte numri total I kesteve te kredise, nese levrimi i kredise behet me keste te paguar nga kredidhenesi.

k – eshte numri ne vazhdimesi per kestet e kredise, nese levrimi i kredise behet me keste te paguara nga kredidhenesi, keshtu qe $1 < k < m$ dhe/ose $1 = k = m$.

K_k - eshte vlera faktike e kredise se vene ne dispozicion te klientet ne periudhen k.

tk – eshte intervali, I shprehur ne vite dhe fraksione te nje viti, ndermjet dates se vleres se kestit te pare te kredise te vene ne dispozicion te klientit (nese levrimi I kredise behet me keste) dhe dates se cdo kesti pasues te kredise te vene ne dispozicion te klientit, domethene $t_1 = 0$.

m' – eshte numri total I kesteve te paguara nga klienti per shlyerjen e kredise dhe/ose pagesave te shpenzimeve.

l – eshte numri ne vazhdimesi I kesteve te paguara nga klienti per shlyerjen e kredise (shlyerja ose pagesa e shpenzimeve).

R_l – eshte vlera e kestit te shlyerjes ose pageses se shpenzimeve nga klienti ne periudhen l.

tl – intervali, i shprehur ne vite dhe fraksione te nje viti, ndermjet dates se vleres se kestit te pare te kredise te vene ne dispozicion te klientit (nese levrimi i kredise behet me keste) ose dates se levrimit te kredise, ne rast se levrimi i kredise behet i plote dhe dates se cdo kesti per shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese qe paguan klienti.

$i = NEI$ mund te llogaritet (nga algjebra ose nga nje program kompjuteri) kur termat e tjere ne ekuacion jane te njohur nga kontrata ose ndryshe.

Per nje perlllogaritje sa me te sakte te NEI, ju lutemi drejtohuni prane nje prej degeve te banks Societe Generale Albania.